



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly



Legjislatura IV
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 19 mars 2014, pas zhvillimit të procedurës së votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media nga Komuniteti shumicë shqiptar emërohen:

1. Adnan Merovci, me mandat katër (4) vjeçar,
2. Driton Qeriqi, me mandat tre (3) vjeçar,
3. Anita Morina-Saraçi, me mandat dy (2) vjeçar.

II. Kandidatët e propozuar për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komuniteteve joshumicë nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

III. Komisioni i Pavarur për Media duhet të nxjerr shpallje publike për zgjedhjen e anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshumicë, në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 04-V-803
Prishtinë, më 19 mars 2014

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të Pavarur për Media,
- Komisionit ad hoc,
- Arkivit të Kuvendit.